

C.nr.435/13

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren Mevlide Shabani, në çështjen kontestimore të paditësit A. A., nga f. Topanicë, K. Kamenicës, të cilin me autorizim e përfaqëson av. Selami Rexhepi, nga Gjilani, kundër të paditurit E. L., ng f. Kmetovc K. e Gjilanit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. Kadri Syla, nga Gjilani, për shkak të pagimit të borgjit, pas mbajtjes së seancës kryesore me datë 14.11.2013, mori këtë :

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar kërkesë padia e paditësit A. A., nga f. Topanicë, Komuna e Kamenicës, e ushtruar kundër të paditurit E. L., nga f. Kmetovc, Komuna e Gjilanit, me të cilën ka kërkuar që të obligohet i padituri në emër të borxhit ti paguaj paditësit shumën prej 2500.00 (dymijëepesqindë Euro) €, për çmimin e pa paguar për blerjen e prerësës për lidhjen e kashtës dhe barit të tipit "Klas – markand 45" si dhe ti kompensoi shpenzimet e procedurës kontestimore duke e përfshi përpilimin e padisë si dhe për 5 seanca gjyqësore, si dhe kamatën ligjore në shumë prej 3,5% nën kanosjen e ekzekutimit të dhunshëm.

Shpenzimet e procedurës sejcila palë i bartë të vetat, ndërsa në pjesë të barabartë për përpilimin e aktgjykimit shumën prej 50 €, e tërë këtë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Duke ju përfillur sygjërimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, sipas aktvendimit Rev.nr.78/2011, gjykata themelore në Gjilan, ka rihapur seancën gjyqësore dhe i ka ftuar palët ndërgjyqëse në procedurë.

Përfaqësuesi i paditësit av. Selami Rexhepi, në seancën e shqyrtimit kryesorë ka bërë precizimin e padisë në kuptimin objektiv dhe në emër të borxhit ka kërkuar shumën prej 2500 €, në raport me shitblerjen e makinës presëse të sanës të tipit "Markand 45", dhe ka theksuar se në maj të vitit 2008, paditësi këtë makinë e kishte sjellë nga Serbia, e në marrëveshje me të paditurin me datë 18.05.2008, ja kishte sjellë në shtëpinë e tijë në fsh. Kmetovc, ku ishin marrë vesh që i padituri ta shiste dhe se çmimi i sajë i tërësishëm ishte në vlerë prej 4000 €, mirëpo pasi paditësi kohë më parë kishte marrë në emër të borgjit shumën prej 1500 €, i padituri lidhur me këtë makinë nuk i kishte dorëzuar edhe shumën e të hollave prej 2500 €, paditësit.

Më tutje përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se dëshmi për sjelljen e kësaj makine dhe dorëzimin e sajë në oborrin e shtëpisë së të paditurit janë deklaratat e dëshmitarëve të cilat

gjinden në shkresat e lëndës edhe atë deklarata e dëshmitarit V. M. si dhe E. S., të cilët me rastin e transportit kishin marrë pjesë, duke theksuar se nga kjo rezulton se i padituri i ka mbetur borgj paditësit shumë e mjeteve prej 2500 €.

Përfaqësuesi i të paditurit av. Kadri Sylja, e ka kundërshtuar kërkesë padinë e paditësit të precizuar në seancën e shqyrtimit kryesor si të pa bazuar duke theksuar se padia e paditësit nuk ka mbështetje në asnjë provë dhe se i padituri nuk i ka mbetur borgj shumë prej 2500 €, për sjelljen e makinës së theksuar të tipit këllas 45, nga arsyeja se vetë paditësi në shqyrtimin e më hershëm gjyqësor në gjykatë ka deklaruar se i padituri për blerjen e kësaj makine paraprakisht ia kishte dhënë paditësit 4000 €, të cilën e kishte blerë në Serbi, për shumë e të hollave prej 3.300, € si dhe 200 € për transport e që tërë shuma e paguar për këtë makinë ishte prej 3500 €, e që rezulton se edhe 500 €, nga shuma të cilën i padituri ia kishte dhënë paditësit nuk ju kishin kthyer e që paditësi për këtë makinë i ka mbetur borgj të paditurit edhe 500 €. Më tutje përfaqësuesi i të paditurit ka deklaruar se këtë që e pohova paditësi e ka deklaruar në aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan, C.nr.328/08, të datës 21.10.2009, në faqen e dytë në pasuesin e dytë.

Paditësi A. A., në cilësi të palës në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se i padituri E. L., më ka mbetur borgj shumë e të hollave prej 2500 €, për presën e cila bëhet fjalë në padi, duke theksuar se tri ditë pa ja sjellë makinën prerëse i padituri i kishte dhënë 1500 €, e cila presë kishte kushtuar 4000 € e që i padituri të hollat ishte dashur me ia dorëzua paditësit pasi ta shesë presën në fjalë duke shtuar se pas dy javësh kishte kërkuar nga ai që ti japë edhe 2500 €, se paditësi pretendon se i ka mbetur borgj i padituri por i njëjti i kishte thënë se presën nuk po e shes por po e ndali për vete duke u arsyetuar se nuk i kishte më borgj.

I padituri E. L., në cilësi të palës në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se me paditësin janë takuar në treg në Kamenicë, pasi që të dy ishin marrë me shitblerjen e këtyre makinave, paditësi i kishte thënë të paditurit se a donë me e blerë një makinë prerëse se e ka për ta shitur një serb në fsh. Hajnovc, ku i padituri edhe e kishte blerë në shumë prej 2650 €, të cilën shumë thot se ja ka paguar menjëherë, Vlladicës, ndërsa sa i përket prerëses e cila është objekt i kontestit për të cilën paditësi deklaroi se i ka mbetur borgj, i padituri thekson se kjo prerëse nuk është e llojit "kllasë 45" por e llojit "kllasë 50", pasi paditësi kishte marrë nga i padituri shumë e të hollave prej 1.500 €, hua për 24 orë dhe se 500 € i kishte mbetur borgj për presën e parafundit e cila është edhe objekt i kontestit, e llojit "kllasë 45" e të cilën paditësi e kishte blerë 3.500 € e nga i padituri kishte marrë 4.000 €, i padituri kishte kërkuar nga paditësi tia kthejë të hollat ose ti sjellë një makinë prerëse, pasi paditësi një presë e kishte pasur në shtëpinë e tij e në marrëveshje me paditësin djali i të paditurit kishte shkuar në fsh. Topanicë te firma "Përparimi", e kishte marrë presën dhe e kishte sjellur në shtëpinë e të paditurit.

Më pastaj i padituri kishte kërkuar nga paditësi që të barazohen me gjendjen se ku kishin arritur me të hollat dhe me vlerën e makinave, atëherë paditësi në shtëpinë e të paditurit me një fl. A4 e kishte paraqitur gjendjen duke e shkruar me dorën e vetë, pasi që i padituri pretendonte se paditësit gjithsejtë për sjelljen e makinave i kishte dhënë shumë prej 7900 €, ndërsa paditësi në fl. i kishte llogaritur shumë prej 7.800 €, atëherë i padituri ka kërkuar nga paditësi t'ia kthejë të hollat në shumë e lartëkur dhe i padituri t'ia kthejë tri makinat që i kishte sjellë paditësi në shtëpinë e të paditurit. Marrëveshja gojore ishte prishur pasi që paditësi e kishte ndryshuar çmimin e makinave dhe për këtë arsye i padituri edhe kishte kërkuar nga paditësi kthimin e të hollave të cilat paraprakisht ia kishte dhënë në shumë prej 7.900 €.

I padituri më tutje ka deklaruar se ka pritur nga paditësi 3 javë që t'ia kthejë të hollat e ai ti kthen makinat por pasi që paditësi nuk ja kishte kthyer të hollat i padituri ishte detyruar ti shesë ato makina për ti nxjerrë shumën e të hollave që i kishte dhënë paditësit pasi ato makina ishin blerë me të hollat e të paditurit nga ana e paditësit me qëllim që fitimi mbetur të ndahej përgjysmë.

Gjykata kishte dëgjuar edhe dëshmitarin V. M., E. Th. dhe B. H..

Dëshmtari V. M. fsh. Hajnovc, në deklaratën e tij të dhënë në këtë gjykatë në maj të vitit 2008, kishte deklaruar se në shtëpinë e tij kishin shkuar paditësi dhe i padituri dhe të njëjtit ishin marrur vesh për shitblerjen e një makine – prerëse të barit për çmimin prej 2.650 €, pasi që ai më parë këtë makinë ia kishte sjellur paditësit, me atë rastë i padituri paditësit ia ka bërë pagesën në tërësi, ashtu që e kishin transportuar makinën në shtëpinë e të paditurit në f. Kmetovc. Më tutje dëshmitari kishte deklaruar se pas 15-20 ditësh së bashku me paditësin, të paditurit ia kishin dërguar edhe 3. prerëse të tjera dhe se ai kishte qenë vetëm si auto transportues me traktor, ndërsa se me parat e kujt ishin paguar këto prerësa nuk e kishte ditur por për transport kishte marrë 100 € për copë.

Dëshmitari E. Th., në këtë gjykatë kishte deklaruar se është pronar i “Gurthyesit “në f. Kmetovc, dhe se diku para 2. viteve të “Gurthyesi” paditësi dhe i padituri por edhe disa persona të nacionalitetit serb e kishin sjellë një makinë, prerëse të barit dhe të njëjtën e kishin zbratur me bagerin e tyre nga kamioni. Se a është bërë pagesa lidhur me këtë makinë dëshmitari nuk ka patër njohuri, lidhur me shitjen e asaj makine dëshmitari nuk ka patër njohuri por e din se ka qenë e tipit këllas, dhe sipas vlerësimit të tij ka mundur të kushtoi rrethë 3.000 €.

Dëshmitari B. H., kishte deklaruar se nga i padituri E. ka blerë një makina lidhëse të barit gjatë vitit 2008, dhe dy të tjera i kishte blerë në pranverën viti 2009. makinën e parë e kishte blerë në shumë prej 2.500 € dhe e njëjta kishte qenë e tipit “Kllas 60” ndërsa pagesën ashtu siq ishim marrur vesh ia kishte paguar pas 3. muajsh. Dy makina tjera së bashku me pjesë rezervë i kishte blerë për çmimin e shitblerjes prej 5.800 €, dhe se të njetjat i kishte paguar me rata por obligimin e kishte përmbushur në tërësi dhe se këto dy makina kishin qenë të tipit “Kllas 50”. I njëjti nuk kishte pasur njohuri se nga kush i ka marrur këto makina i padituri.

Pas vlerësimit me kujdesë të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si një kuptim të nenit 8. të LPC., si dhe në bazë të rezultatit të gjithëmbarrëshëm të procedurës kontestimore, gjykata konstatoi këtë gjendje faktike:

Nga deklarata e paditësit A. A., gjykata vërtetoi faktin se paditësi pasi e kishte vu në kontakt të paditurin me dëshmitarin V. M., nga fsh. Hajnovc, dhe pas blerjes së asaj makine, paditësi kishte kërkuar bashkëpunim me të paditurin që në të ardhmen paditësi të sjellë presat nga Serbia ndërsa i padituri ti shesë por fitimin e mbetur ta ndajnë përgjysmë, e që paditësi të hollat për blerjen e makinave prese paraprakisht ti merrë nga i padituri të cilën gjë paditësi vetë e ka pohuar gjatë dhënjes së deklaratës së tij duke thënë se më parë i ka marrë të hollat nga i padituri e më pastaj i ka sjellur makinat.

Nga deklarata e të paditurit E. L., gjykata vërtetoi faktin, se me paditësin ishin njohur edhe më herët pasi që të dy ishin marrë me shitblerjen e makinave presëse të sanës, një ditë në tregun e Kamenicës, paditësi por sa e kishte takuar të paditurin e kishte pyetur se a don me blerë një makinë presëse duke e njoftuar se e ka një serb në fsh. Hajnovc për me e shitë. Po ashtu

gjqqtarja kuptoi faktin se presa për të cilen pretendon paditësi në kërkesëpadi nuk ishte objekt i kontestit, por ajo i ishte sjellë më herët të paditurit, për të cilën paditësi para se ta sillte e kishte marrë nga i padituri shumën prej 4.000 €, ndërsa presën e kishte blerë në shumë prej 3.500 €, ndërsa lidhur me shumën prej 500 €, të mbetura nuk i kishte dhënë sqarim të paditurit.

Po ashtu nga deklarata e tije, gjykata kuptoi edhe faktin se paditësi kishte kërkuar nga i padituri edhe shumën prej 1.500 €, hua për 24 orë, dhe të njëjtat nuk ia kishte kthyer.

Gjykata kuptoi faktin se i padituri nuk i kishte blerë makinat prese nga i padituri por i kishte sjellë tek ai e më pastaj i padituri ti shet dhe fitimi të ndahej përgjysmë, më tutje i padituri kishte deklaruar se si paditësi me një fletë A-4 e kishte shkruar me dorën e tije shumën e të hollave në vlerë prej 7.800 €, të cilat i padituri ia kishte dhënë, por pasi që rreth kësaj shume nuk ishin kuptuar pasi i padituri pretendonte se paditësit i kishte dhënë shumën prej 7.900 €, i padituri kishte kërkuar që paditësi tia kthejë shumën e të hollave prej 7.900 € që i kishte dhënë paraprakisht dhe i padituri t'ia kthejë tri makinat të cilat paditësi ja kishte sjellur në shtëpi atij, e që ende nuk ishin shitur, pasi paditësi nuk ja kishte kthyer të hollat pas 3 javësh i padituri këto makina i kishte shitur me qëllim të nxjerrjes së parave të tija të cilat i kishte investuar ai.

Gjykata me qëllim të krahasimit të besueshmërisë së deklaratave të palëve ndërgjyqëse lexoi edhe procesverbalet e shqyrtimeve kryesore të mëhershme të datës 13.08.2009, të datës 17.09.2009, të datës 21.10.2009.

Gjykata besimin nuk ia fali deklaratës së paditësit A. A., pasi deklaratat e tija ishin në kundërshtim njëra me tjetrën dhe nuk përputheshin me deklaratën e dhënë në cilsin të palës në procesverbalin e datës 13.08.2009, ndërsa deklaratës së të paditurit ia fali besimin pasi që deklaratat e tija nuk ishin në kundërshtim dhe përputheshin njëra me tjetrën.

Në bazë të analizimit të provave materiale dhe personale, gjykata e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar

Nga arsyerat e cekura më lartë dhe bazuar në nenin 143 u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA KOMUNALE NË GJILAN
Me datë 14.11.2013

Gj y k a t ë s j a ,
Mevlide Shabani d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në Gjilan, në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të të njëjtit . Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj Gjykate.